VENDIM
Nr. 589, datë 18.10.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT GJIROKASTËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike të qytetit Gjirokastër".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Gjirokastër.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 18 924 850 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 18 924 850 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Gjirokastër.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Gjirokastër.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Gjirokastër.
8. Bashkia Gjirokastër kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Gjirokastër.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Gjirokastër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Gjirokastër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Gjirokastër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILIT SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT GJIROKASTËR"

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimi për shpronësim				
											Truall			Vlera totale në (lek)	Shënime
	Emri	**Atësia**	**Mbiemri**	**Fshati ose qyteti**	**Zona kadastrale**	**Numri i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja totale**	**Volumi**	**Faqe**	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)		
1	Javer	Osman	Zani	Gjirokastër	8543	25/37	Truall	18722	4	15	3890	4865	18,924,850	18,924,850	Konfirmuar nga ASHK-ja. Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
Vlera totale														**18,924,850**	